

NJOFTIM

TURKIYE IS BANKASI A.S. – Dega në Kosovë, nëpërmjet këtij njoftimi informon të gjithë klientët që deri në vendimin apo rekomandim e ardhshëm të nxjerrë nga organet kompetente shtetërore, do të vazhdojë punën duke ofruar shërbime për të gjithë klientët.

Sidoqoftë, për shkak të situatës së krijuar si pasojë e përhapjes së virusit **COVID-19** (i njohur edhe si "Coronavirus") të cilën gjendje e ka shpallur pandemi "Organizata Botërore e Shëndetit", dhe pas vendimeve dhe rekomandimeve të ndryshme dhe të vazhdueshme nga Qeveria e Republikës e Kosovës, ju informojmë si në vijim:

1. Për të parandaluar përhapjen e mëtutjeshme të virusit, ju rekomandojmë që të minimizoni kohën e qëndrimit tuaj në degët tona, dhe të përdorni kanalet alternative për të kryer transaksionet bankare (e-banking, kartat e debitit etj.), ose të komunikoni me stafin tonë përmes telefonit ose me postë elektronike për të gjitha çështjet që mund të diskutohen pa qenë e nevojshme të vini fizikisht në degët e bankës tonë.
2. Nëse keni simptoma të sëmundjes dhe/ apo vështirësi në frymëmarrje, ju duhet të qëndroni në shtëpi dhe të mos vini në bankë derisa të keni bërë testin dhe të jetë konfirmuar se ju nuk jeni i infektuar.
3. Për shërbimet bankare të cilat nuk mund të kryehen pa qenë fizikisht të pranishëm në Bankën tonë, dhe të cilat nuk mund të shtyhen për një datë tjetër të mëvonshme, ju udhëzoheni të merrni të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, të rekomanduara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe të zbatoni udhëzimet tona të brendshme, siç përcaktohen në këtë njoftim. Veprimet e tilla, ndër të tjera, përfshijnë:
 - Ju duhet të dezinfektoni duart tuaja me dezinfektuesit e vendosur në hyrje të Bankës, menjëherë pas hyrjes në ambientet e bankës.
 - Pasi të hyni në ambientet e Bankës, duhet të mbani një distancë prej të paktën 1.5 metra nga klientët e tjerë dhe stafi i bankës.
 - Ju duhet të shmangni përshëndetjet me shtrengim dore me klientët e tjerë dhe me stafin e bankës.
 - Ju duhet të mbuloni gojën dhe hundën me shami kur kolliteni, teshtini ose së paku të përdorni pjesën e brendshme të bërrylit tuaj.
 - Ju duhet të hidhni në mbeturina menjëherë shaminë e përdorur kur kolliteni ose teshtini.
 - Ju nuk duhet të qëndroni pa nevojë në ambientet e bankës, dhe duhet të largoheni menjëherë pasi të keni përfunduar punën në bankë.

Ky njoftim nuk i zëvendëson këshillat mjekësore, prandaj klientët udhëzohen të kontaktojnë menjëherë institucionet mjekësore në rast se kanë simptoma të infektimit me virusin COVID-19.

TURKIYE IS BANKASI A.S. - Dega në Kosovë ju falënderon për mirëkuptimin dhe ju uron shëndet ju dhe familjeve tuaja.